



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-019

Prishtinë, më 13 shtator 2021, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 SHTATOR 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, më 9 gusht 2021,
2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtura më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021,
3. Pika e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 gusht 2021,
4. Përgatitjet për seancë të re plenare,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 9 gusht 2021

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 9 gusht 2021.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021

3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 gusht 2021

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seancat plenare nga pikat 2 dhe 3 të lartshënuara.

Në lidhje me pikat e lartshënuara, diskutuan: kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri; kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, dhe kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia vendosi që sesioni vjeshtor i Kuvendit të fillojë me seancë të re plenare, ndërsa në këtë mbledhje nuk vendosi për datën e mbajtjes së vazhdimit të seancave plenare me pikat e papërfunduara.

* * *

Kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, e ngriti çështjen e mosprocedimit në Kuvend nga Qeveria të marrëveshjen financiare për nxitjen e levimit të mundësive për sektorin e ujit Flous 2, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me çështjen e shtruar nga kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, diskutoi kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, diskutimi i së cilës është i dhënë në transkript.

Po ashtu, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, kërkoi që në seancën e re plenare të Kuvendit të diskutohet për gjendjen me pandeminë COVID-19, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, diskutuan: kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila; kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, kryetari konstatoi se me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të PDK-së, LDK dhe AAK, diskutimi apo kërkesa për debat parlamentar në lidhje me gjendjen me pandeminë COVID-19, do të procedohet pasi të përgatitet kjo çështje.

* * *

4. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të hënën, më 20 shtator 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit,*
- 6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tetë (8) anëtarë nga komuniteti shqiptar dhe një (1) anëtar nga komuniteti serb të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

Po ashtu, në lidhje me pikën 6 të lartshënuar, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 20. 9. 2021, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tetë (8) anëtarë nga komuniteti shqiptar dhe një (1) anëtar nga komuniteti serb të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, zëvendëskryetarin e parë dhe katër (4) anëtarë; GP i PDK-së, dy (2) anëtarë; GP i LDK-së, kryetarin (i cili nuk duhet të jetë kryetar i ndonjë komisioni parlamentare); GP i Listës serbe, një (1) anëtar; GP i AAK-së, një (1) anëtar dhe GP Multietnik, nënkryetarin e dytë.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Konkluzionet finale nga takimi i pestë i Nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Kosovës, në kuadër të MSA-së, më 9 dhe 10 qershor 2021 e ka mbajtur takimin e pestë (5) dhe nga konkluzionet finale të këtij takimi janë dhënë rekomandimet për disa institucione, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Në lidhje me konkluzionet e lartshënuara, Kryesia nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Konkluzionet finale nga takimi i pestë i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Kosovës u dërgohen komisioneve parlamentare.
2. Kërkohej nga komisionet parlamente, sipas fushëveprimit, t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga konkluzionet.

Të ndryshme:

1. Masat për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19

Kryetari i njoftoi të pranishmit me masat për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 të vendosura me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/32, datë 28. 8. 2021.

Diskutimi i kryetarit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 14:10 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale